



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 114
Prishtinë, më 17 qershor 2010

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 17 QERSHOR 2010

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmuan **Slobodan Petroviq** dhe **Xhavit Haliti**, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur këtë rend dite për seancën e sotme plenare:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për qasje në dokumente publike,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2009,
7. Shqyrtimi i Raportit të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009,
8. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2009,
10. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave,

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: **Xhevdet Neziraj, Ismet Beqiri, Ismajl Kurteshi, Myrvete Pantina, Rexhep Hoti, Esat Brajshori, Ardian Gjini, Naser Rugova, Driton Tali, Gani Koci dhe Riza Smaka**, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë, Enevr Hoxhaj, lidhur tenderin për pajisjen e shkollave me teknologji informative

Ministri **Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja **Njomza Emini** parashtroi pyetje për zv/kryeministrin, Hajredin Kuçi lidhur përmirësimin e gjendjes për pikat e ngritura në Raportin e progresit të Komisionit Evropian, si: prokurimi publik dhe politizimi i administratës.

Zv/kryeministri Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Emini.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me bilancin e pagesave dhe bilancin tregtar të vendit me jashtë.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Naim Rrustemi** parashtroi pyetje për zv/kryeministrin, Hajredin Kuçi, lidhur me nxjerrjen e Udhëzimit administrativ nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e Ligjit për prokurimi publik..

Zv/kryeministri Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

Deputetja **Elheme Hetemi** parashtroi pyetje për ministren e Administratës Publike, Edita Tahiri, lidhur me çështjen e ngritur nga shefi i ICO-s, Piter Feith për bashkëpunimin me Republikën e Serbisë për regjistrimin e popullsisë.

Ministrja **Tahiri** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hetemi.

Deputeti **Abdyl Ymeri** parashtroi pyetje për ministrin e Drejtësisë, Haki Demolli, lidhur me krijimin e kushteve për rikthimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në objektin e Gjykatës në veri të Mitrovicës.

Ministri **Demolli** iu përgjigj pyetjes së deputetit Ymeri.

Deputeti **Naim Rrustemi** parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me Udhëzimin administrativ nr. 12/2009 për shfrytëzimin e pajisjeve elektronike nga ana e tregtarëve të parë të FED.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

Deputetja **Mimoza Ahmetaj** parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me kthimin e mjeteve të privatizimit dhe të pensioneve për t'i investuar në Kosovë.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes Ametaj.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me angazhimin e këshilltarëve strategjikë për privatizimin e PTK-së.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Pas mbarimit të kohës për pyetje parlamentare, **kryetari** konstatoi se në sallë janë të pranishëm **73 deputetë** dhe procedoi me shqyrtimin e pikave të tjera të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për qasje në dokumente publike

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin për qasje në dokumente publike.

Zëvendëskryeministri, **Ramë Manaj**, gjatë prezantimit të Projektligjit tha se qëllimi i këtij projektligji është të përcaktojë parimet themelore për qasje në dokumentet publike.

Me miratimin e këtij Projektligji shfuqizohet Ligji numër 2003/12 për qasje në dokumente zyrtare. Ky projektligj është harmonizuar me Kushtetutën dhe me instrumentet ligjore ndërkombëtare, të cilat janë pjesë direkte e zbatimit në Republikën e Kosovës, si dhe në veçanti është marrë parasysh Konventa e Këshillit të Evropës për qasje në dokumente zyrtare, e vitit 2009, dhe parimet ndërkombëtare mbi të drejtën për qasje në informata.

Qasja e lirë në dokumentet publike, të cilat i mbajnë autoritetet publike, mundëson që qytetarët të jenë më mirë të informuar, kurse nëpunësit e autoriteteve publike më përgjegjës, gjë që pakëson rrezikun nga keqpërdorimi i fuqisë dhe siguron respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut e që përkon edhe me synimet dhe përpjekjet e Qeverisë dhe të institucioneve tjera të vendit tonë.

Ky ligj zbatohet mbi të gjitha autoritetet publike, si dhe për të gjitha dokumentet që hartohen, mbahen apo pranohen nga autoritetet publike.

Miratimi i këtij Projektligji paraqet një hap përpara në avancimin e të drejtave të njeriut, si dhe ngritjen e transparencës në Republikën e Kosovës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për qasje në dokumente publike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për qasje në dokumente publike dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hajredin Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Esat Brajshori**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Melihate Termkolli**, në emër të

Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Petar Miletij** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Numan Baliq**, si dhe deputetët: **Rexhep Hoti**, **Bujar Dugolli**, **Riza Smaka**, **Ibrahim Gashi** dhe **Driton Tali**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në fund, zëvendëskryeministri Manaj iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve dhe i ftoi ata që ta miratojnë këtë projektligj.

Më pas, Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56;

Kundër----- 8.

Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për qasje në dokumente publike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokale dhe Media – si komision funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve, nga data e miratimit në parim, dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Ministri, **Ahmet Shala**, gjatë prezantimit të Projektligjit tha se qëllimi i këtij projektligji është që të ndikojë në ngritjen e nivelit të depozitave nëpër bankat komerciale të Kosovës. Me këtë Projektligj parashihet krijimi i një institucioni të ri me stafin përkatës që do të merret me implementimin e mbarëvajtjes së këtij ligji dhe bazuar në të dhënat aktuale sa i përket depozitave, si dhe nivelin e sigurimit të këtyre depozitave, do të duhet të kemi një fond prej 15 milionë euro, 5 milionë euro i ka afruar KfV-ja, pra Banka për Zhvillim e Republikës Gjermane, si grand për themelimin e këtij fondi, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës është zotuar që në vitin 2011 – 2013 t’i shtojë edhe 10 milionë euro. Sigurisht ky është fondi fillestar, ndërsa me rritjen e depozitave do të kërkohet edhe fond më i lartë.

Për të menaxhuar me këtë fond do të krijohet një Agjenci, siç ka qenë ideja e parë, në të cilën në baza ditore dhe në baza periodike do të kontrollohet dhe raportohet në Bankën Qendrore mirëvajtja e menaxhimit dhe e investimeve të këtyre parave, si dhe do të sigurohet që Bordi i Bankës Qendrore të jetë mbikëqyrës i vetëm ndaj këtij fondi, i cili do të jetë tepër i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës.

Nga bisedimet që i kemi pasur me Fondin Monetar Ndërkombëtar është kërkuar që edhe ky projektligj të miratohet para 15 korrikut. Ai ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë këtë Projektligj.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Myervete Pantina**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Muferra Shinik**, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Mursel Halili** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Vezira Emrush**, si dhe deputetët: **Rexhep Hoti**, **Rita Hajzeraj-Beqaj**, **Armend Zemaj** dhe **Saniye Aliaj**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Në fund, ministri Shala iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve dhe i ftoi ata që ta miratojnë këtë projektligj.

Më pas, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61;
Kundër----- 0.
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa – si komision funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve, nga data e miratimit në parim, dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2009

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar Raportin e punës së Agjencisë së Pronës, për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për miratim.

Ai ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta arsyetojë raportin para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, tha se Komisioni ka shqyrtuar me vëmendje Raportin e Agjencisë së Pronës dhe ka konstatuar se raporti është i bazuar në Ligjin për Agjencinë.

Ajo çka vlen të theksohet është se numri i qytetarëve të Kosovës që kanë parashtruar kërkesa është shumë i madh. Deri më tani Agjencia ka pranuar mbi 40.000 kërkesa, që është sfidë për Agjencinë t’i shqyrtojë brenda afateve, kur edhe qytetarët e Kosovës kanë nevojë ta zgjidhin problemin e pronësisë. Kërkesat kanë të bëjnë për çështje të ndryshme të pronës, edhe për pronën komerciale, edhe për pronën private.

Po ashtu, vlen të përmendën se janë dy probleme, të cilat i ka hasur Komisioni. E para, Kuvendi i Kosovës ka refuzuar propozimin për emërimin e dy anëtarëve vendorë të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë. Agjencia vepron pa anëtarë të bordit ekzistues. Prandaj, i rekomandojmë Qeverisë së Kosovës, që sa më parë t'i rekomandojë anëtarët vendorë të bordit. Çështje tjetër me interes është që zyrat të cilat kanë qenë funksionale në Beograd, janë mbyllur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe kjo ka sjellë një situatë që e ka ndërlikuar procesin e ndihmës sa i përket dokumentacionit, i cili aktualisht nuk është në Kosovë.

Prandaj, duke i pasur parasysh këto sfida që u përmendën më lart, Komisioni ka vendosur që Kuvendit t'ia propozojë rekomandimet, që u janë shpërndarë të gjithë deputetëve.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin e Raportit të punës së Agjencisë së Pronës, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Avdiu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vladimir Todoroviq, si dhe deputetët: Rexhep Hoti, Naim Maloku, Sanije Aliaj dhe Driton Tali, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----44,
Kundër-----11,
Abstenime-----7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin punës së Agjencisë së Pronës, për vitin 2009.

7. Shqyrtimi i Raportit të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ka shqyrtuar Raportin e punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ai ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta arsyetojë raportin para deputetëve të Kuvendit.

Kryetarja e komisionit funksional, **Myzejene Selmani**, në emër të komisionit e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit Raportin e punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputeti, Rexhep Hoti, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----66,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009.

8. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009

Kryesuesi njoftoi deputetët se Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ka shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ai ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta arsyetojë raportin para deputetëve të Kuvendit.

Kryetarja e komisionit funksional, **Myzejene Selmani**, në emër të komisionit e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit Raportin e punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha -Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Et'hem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar, "7+" , Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Rexhep Hoti, Drita Maliqi, Driton Tali, Gani Buçinca, Xhavit Haliti dhe Emrush Xhemajli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----45,
Kundër-----11,
Abstenime-----13.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009, me rekomandimet e komisionit funksional.

9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2009

Kryesuesi, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike tha se Komisioni funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin e punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2009 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për miratim.

Në vazhdim, **Esat Brajshori**, në emër të komisionit funksional, para deputetëve të Kuvendit e arsyetoi raportin me rekomandime. Ai tha se ky raport është mirë i përgatitur dhe është mjaft përmbajtjesor. Komisioni funksional ka vërejtur se raporti nuk përmban pjesën e të dhënave për të punësuarit pa konkurs në Shërbimin civil të Kosovës, gjë e cila në të ardhmen duhet bërë.

Më tej, ai theksin e fjalës e vuri te moszbatimin në praktikë të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, vendime këto të cilat sipas ligjit janë të formës përfundimtare në procedurë administrative.

Moszbatimi i këtyre vendimeve është një dukuri mjaft shqetësuese, e cila në të ardhmen nuk bën të lejohet, potencoi ai.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Abdyl Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Melihate Termkolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, në emër të Grupit Parlamentar, “7+” , Sadik Idriz, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Branislav Grbiq, si dhe deputetët: Naim Rustemi, Mimoza Ahmetaj, Riza Smaka, Bahri Hyseni, Sanije Aliaj, Bajram Kosumi, Gani Buçinca, Ismajl Kurteshi dhe Ibrahim Makolli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,
Kundër-----2,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2009, me rekomandimin e komisionit funksional.

10. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

Kryesuesi, në fillim të shqyrtimit kësaj pike tha se Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar kërkesën për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe Kuvendit ia ka rekomanduar, për miratim.

Në vazhdim, **Armend Zemaj**, në emër të komisionit funksional, para deputetëve të Kuvendit, e arsyetoi raportin.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e kërkesës për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Drita Maliqi, në emër të Grupit Parlamentar, “7+” , Sadik Idriz, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Bujar Dugolli, Naim Rustemi, Safete Hadergjona, Ibrahim Makolli dhe Armend Zemaj, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** konstatoi se në mungesë të kuorumit, votimi për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, shtyhet për seancën e radhës.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 18:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI